



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT
(Përfundimtar)**

**PËR
MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL
INSTITUTI I SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË
(ISUV)**

Tiranë, Janar 2017

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të Vendimit nr. 138, datë 30.12.2015 *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes me nr. 623, datë 18.10.2016, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 623/1, datë 18.10.2016, *“Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në ISUV”*, i është njoftuar Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Procesi i mbikëqyrjes në këtë institucion, filloi në datën 24.10.2016.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, (ISUV) është strukturë administrative e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, e krijuar me Vendimin nr. 515, datë 19.07.2006, të Këshillit të Ministrave, *“Për Ristrukturimin e Instituteve Kërkimore-Shkencore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”*, konkretisht në pikën 8 të këtij vendimi.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë përfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar. Përfshirja e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në *“Listën e institucioneve të administratës shtetërore”*, që hyjnë në fushën e shërbimit civil, është e parashikuar në Lidhjen nr.1, (me numër rendor 61), e cila është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilat, evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil; deklarimin e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar; respektimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil; hartimin e formularit të përshkrimit të punës; miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil; rekrutimet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar; transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm; pezullimin nga shërbimi civil; realizimin e vlerësimeve të punës për nëpunësit civil; kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Gentiana Agushi dhe Alda Xhaxhiu, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, Ilia Kukumi, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, të cilin ia ka dërguar për njohje institucionit me shkresën nr. 623/2 prot., datë 23.12.2016, duke i lënë 15 ditë kohë, për të paraqitur observacionet

Me shkresën nr. 623/3, datë 23.12.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundimit të mbikëqyrjes në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur.

Me shkresën nr. 623/4, datë 23.12.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundimit të mbikëqyrjes në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje edhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është lënë institucionit të mbikëqyrur për të paraqitur komentet përkatëse, rezulton se, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga personat përgjegjës, me shkresën nr. 27 prot., datë 12.01.2017, *“Kthim përgjigje”*, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 623/5 prot., datë 13.01.2017.

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse rezulton se, institucioni nuk ka paraqitur vërejtje në lidhje me gjetjet e grupit të punës. Po kështu, konkludohet se nga ana e institucionit, është shprehur vullneti për të vijuar procesin e rregullimit ligjor të situatës, duke parashikuar shprehimisht:

- Veprimet që do të kryhen në lidhje me aspekte konkrete të përmendura si parregullsi gjatë administrimit të shërbimit civil, në projektraport, të tilla si, përfundimi i procedurës së hartimit të përshkrimeve të punës dhe saktësimi i statusit të nëpunësit gjatë procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, si dhe
- Afatet konkrete për rivendosjen e ligjshmërisë.

Në këto rrethana, duke u konsideruar e plotësuar kërkesa për zbatimin e procedurës në këtë rast, u hartua dhe raporti përfundimtar i mbikëqyrjes.

Qëllimi i mbikëqyrjes:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë së linjës dhe njësisë përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, të konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.

- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit Civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).

7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm*).
10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).
11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njësisë përgjegjëse*), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes:

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim dhe bashkëbisedim me Drejtorin, *****, (i cili përkohësisht është i ngarkuar nga Ministri i linjës për kryerjen e detyrës së Drejtorit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, me shkresën nr. 2298 prot, datë 23.03.2016, pasi ky pozicion pune është i lirë në kuptim të ligjit), gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim. *****, "*Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore*", u caktua si personi i kontaktit me grupin e punës.
- U verifikuan pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës aktuale të institucionit, si dhe sipas strukturës dhe organigramës që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan përshkrimet e punës për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar.

- U verifikuan formularët e vlerësimit të punës në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civilë të institucionit, dhe, nëse ky proces, është kryer sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës, të çdo nëpunësi, për të provuar përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës, si arsimi, përvoja në punë e të tjera.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (aneks nr. 1, aneks nr. 2, dhe aneks nr. 3), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e pandarë e këtij raporti.

Përmbajtja e raportit:

I. Si është zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në lidhje me deklarinë e statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit

a) Organizimi i pozicioneve të shërbimit civil në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, është institucion që përfshihet për herë të parë në shërbimin civil. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e këtij institucioni, deri në datën 26.02.2014, janë rregulluar nëpërmjet ligjit nr. 7661, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Miratimi i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka sjellë ndryshime për regjimin e administrimit të burimeve njerëzore në këtë institucion, pasi e ka renditur në skemën e shërbimit civil, e parashikuar në mënyrë të shprehur në Lidhjen nr. 1 të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar (numri 61).

Mënyra e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të ligjit të ri për nëpunësin civil, është përcaktuar qartë në këtë ligj, dhe konkretisht, neni 2 i këtij ligji, ka parashikuar se, fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

Në rastin konkret, nga analiza dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se, në datën e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, (në datën 26.02.2014), Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, funksiononte në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrin nr. 72, datë 17.02.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”.

Bazuar në këtë strukturë organizative, në datën e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në datën 26.02.2014), Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë kishte gjithsej **99** vende pune, nga të cilat:

- **64 pozicione pune, konsiderohen pjesë e shërbimit civil**, (1 pozicion me emërtesën “titullar i institucionit, TND” + 1 pozicion me emërtesën “zv/titullar/përgjegjës departamenti” + 4 pozicione me emërtesën “përgjegjës departamenti” + 15 pozicione me emërtesën “përgjegjës sektori” + 16 pozicione me emërtesën “specialist, (me grada/tituj shkencor)” + 18 pozicione me emërtesën “specialist, (pa grada/tituj shkencor)” + 9 pozicione me emërtesën “specialist”).
- **35 pozicione pune kryejnë funksione administrative.**

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar me vendimin nr. 262, datë 25.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil (që zënë rreth **65%** të numrit total të pozicioneve të punës) në këtë institucion, paraqiten në këtë raport:

- **1 pozicion pune**, me emërtesën “Titullar i institucionit/TND” - nëpunës civil, pjesë e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues, që zë **2 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil.
- **1 pozicion pune**, me emërtesën “Zëvendës titullar/Përgjegjës Departamenti”, kategoria e pagës II-b - nëpunës civil të kategorisë së mesme drejtuese, që zë **2 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil.
- **19 pozicione pune**, me emërtesën “Përgjegjës Departamenti” dhe “Përgjegjës Sektori”, kategoria e pagës III-a, III-a/1 dhe III-b - nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese, që zënë **29 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil.
- **43 pozicione pune** të kategorisë ekzekutive, nga të cilat:
 - **16 pozicione pune**, me emërtesën “Specialist (me grada/tituj shkencor)”, kategoria e pagës III-b, që zënë **25 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil.
 - **18 pozicione pune**, me emërtesën “Specialist (pa grada/tituj shkencor)”, kategoria e pagës IV-a, që zënë **28 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil.
 - **9 pozicione pune**, me emërtesën “Specialist”, kategoria e pagës IV-b, që zënë **14 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil.

Nga sa më sipër, rezulton të jetë bërë një ndarje e drejtë e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil dhe atyre që kryejnë funksione administrative, në përputhje me detyrat dhe aktivitetin e këtij institucioni, si strukturë administrative (degë territoriale) e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Konkluzion:

- Në përmbajtjen e strukturës organizative të institucionit të mbikëqyrur, evidentohen në mënyrë të qartë, pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil dhe punonjësit administrativë ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil.
- Numri i punonjësve, për çdo njësi organizative, është brenda kufirit të miratuar me ligjin për administratën shtetërore.

a) Punonjës të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, në datën e fillimit të efekteve juridike të ligjit, (në datën 26.02.2014)

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë si strukturë administrative e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave është përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në nenin 67, me nëntitull “*Statusi i punonjësve dhe nëpunësve aktualë*”, ligji parashikon rregullimin e statusit për nëpunësit dhe punonjësit që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, kryenin detyra në vende pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil.

Në mënyrë më të shprehur, në pikën 3, 4 dhe 6, të këtij neni përcaktohet se:

- pika 3, “*Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë*”;
- pika 4, “*Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji*”;
- pika 6, “*Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit*”.

Më tej, vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar në pikën 1, të Kreut III, “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komnat”, përcakton se:

“Punonjës ekzistues”, sipas pikës 3 të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna, dhe a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil; apo b) janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë nëpunës civilë për shkak të ligjit”.

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarimin e statusit të punësit, pas verifikimit të procedurës së punësit, për të gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga strukturat përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, (njësia e burimeve njerëzore e institucionit, Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse), nëse veprimet e tyre janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarimin e statusit të punësit, u verifikuan dhe u analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në datën 26.02.2014, listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014; dosjet individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (aktet e emërimit, të dhënat lidhur me nivelin e diplomës dhe profilin e arsimit të lartë për çdo punonjës të punësuar në pozicione të shërbimit civil), si dhe plotësimi i kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nga përpunimi dhe analiza e këtij dokumentacioni konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ashtu siç e kemi përmendur edhe më sipër, **Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, kishte 64 pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, të cilat në këtë moment ishin të zëna.**

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë përfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Në këto kushte, deri në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, rekrutimi dhe mbarimi i marrëdhënies së punës, zhvillimi i karrierës, garantimi i të drejtave dhe përcaktimi i detyrimeve për punonjësit e këtij subjekti, janë rregulluar nëpërmjet kontratave, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Nga verifikimi i akteve të emërimit të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil dhe i shënimeve përkatëse në librezën e punës, lidhur me datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, (në datë 26.02.2014), në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, situata për **64** punonjësit e punësuar në pozicionet e shërbimit civil, në raport me statusin e tyre të punësit, ishte e tillë:

- Në **1 rast**, punonjësi ishte pjesë e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (**TND**)
- Në **45 raste**, ishin të punësuar punonjës në të njëjtin vend pune për një periudhë më shumë se një vit.
- Në **18 raste**, ishin të punësuar punonjës në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se një vit.

b) Procedura e deklarimit të statusit të punësit, për nëpunësit dhe punonjësit, që kryenin funksione në shërbimin civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar

Bazuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, neni 4, shkronja “f”, Departamenti i Administratës Publike, paraqitet si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur. Ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, e ngarkojnë njësinë përgjegjëse me disa detyra dhe përgjegjësi specifike, të cilat rrjedhin prej tyre, një nga të cilat është edhe deklarimi i statusit të punësimit, për të gjithë nëpunësit dhe punonjësit që në datën e fillimit të efekteve juridike të tij, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil.

Më konkretisht, pika 6, e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, përcakton se, “*Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësinë përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit*”.

Më tej, në mbështetje të pikës 8, të nenit 67, të ligjit është miratuar vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në përmbajtjen e të cilit janë përcaktuar procedurat e hollësishme, që duhet të kryejë njësinë përgjegjëse, për të realizuar deklarinin e statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se:

Në zbatim të akteve rregullative si më sipër, njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë ministrisë së linjës, pasi ka evidentuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në ISUV, me shkresën nr. 249/1 prot., datë 14.04.2014, i ka dërguar njësisë përgjegjëse (DAP), listën e plotë të punonjësve të institucionit; materialet që përmbanin të dhëna lidhur me mënyrën dhe kohëzgjatjen e punësimit; aktet individuale të emërimit, si dhe materialet shkresore me të dhënat individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Departamenti i Administratës Publike, pas marrjes së dokumentacionit të mësipërm, për çdo të punësuar në pozicione të shërbimit civil, ka verifikuar periudhën e punësimit, (nëse ishte më shumë se një vit, apo më pak se një vit), si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të kërkesave të posaçme për vendin e punës.

Në përfundim të këtij procesi, ***në datën 30.10.2014***, për institucionin e mbikëqyrur, ka përfunduar procedura e deklarinimit të statusit të punësimit. Me shkresën nr. 3296 prot., datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, aktet e deklarinimit i janë përcjellë drejtuesit të institucionit të mbikëqyrur dhe për dijeni edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

• Gjëndja e deklarinimit të statusit të punësimit në Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, për **64 pozicione pune pjesë e shërbimit civil**, paraqitet si më poshtë:

- Në **1 rast**, është deklaruar punonjësi pjesë e Trupës së Nëpunësve të Lartë Civil (**TND**).
- Në **36 raste**, është deklaruar statusi i punësimit për punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit, me statusin e punësimit “*Nëpunës civil*”.
- Në **18 raste**, është deklaruar statusi i punësimit për punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më pak se 1 vit, me statusin e punësimit “*Nëpunës civil në*

periudhë prove”, (nga të cilat në **2 raste**, është deklaruar statusi i punësimit në kundërshtim me ligjin, për shkak të afatit kohor të punësimit në pozicionin e shërbimit civil).

- Në **3 raste**, është vendosur mosdeklarimi i statusit të punësimit.
- Në **2 raste**, nuk është deklaruar statusi i punësimit, për shkak se janë shkëputur marrëdhëniet e punës përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit (për arsye të pensionit të pleqërisë).
- Në **4 raste**, është deklaruar statusi i punësimit, me kushtin që, brenda një afati 2 vjeçar, të plotësohet kriteri i diplomës.

Këto raste po i analizojmë në mënyrë të detajuar në vijim:

➤ **Punonjës, pjesë e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND)**

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, sipas strukturës organizative, rezulton të ketë **1** nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues, i cili është pjesë e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND), e njëkohësisht edhe titullari i këtij institucioni.

Nga këqyrja e akteve administrative në lidhje me procedurën e emërimit të nëpunësit në fjalë, rezulton se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në pozicionin e titullarit të institucionit (nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues) ishte i emëruar me urdhrin nr.234, datë 24.09.2013, punonjësi *****, i cili nuk mundi të përfitojë këtë status, për shkak të dorëheqjes së tij, miratuar me shkresën nr. 3064, datë 29.04.2014.

Më pas, rezulton se për të plotësuar këtë pozicion pune, punonjësi ekzistues i ISUV-it, ***** i është nënshtruar procedurës së pranimit në TND, në zbatim të neneve 27, 29, 30 dhe 31, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civile të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND*”, i ndryshuar.

Në përfundim të procedurave të pranimit në TND, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me aktin nr. 648/6, datë 20.02.2015, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësin *****, si nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues (TND).

Në momentin e mbikëqyrjes, rezulton se me aktin nr. 922/2, datë 04.03.2016, të DAP, punonjësi ***** ka dhënë dorëheqje nga TND dhe në këtë pozicion pune, aktualisht është punonjësi ***** (i cili përkohësisht është i ngarkuar nga Ministri i linjës për kryerjen e detyrës së Drejtorit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, pa të drejtë page, me shkresën nr.2298 prot, datë 23.03.2016).

➤ **Punonjës aktualë të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil”**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u morën në analizë të detajuar të gjitha rastet, kur nga ana e njësisë përgjegjëse (DAP) është deklaruar statusi i punësimit për punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit.

Nominalisht, bëhet fjalë për punonjësit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 1 - “Nëpunës civil”

Nr	Emër Mbiemër <i>Emërtesa e pozicionit të punës</i>	Akti i emërimit <i>(Nr/data e aktit)</i>	Akti i deklarimit të statusit të punësimit sipas ligjit nr.152/2013 “Per nepunesin civil”, i ndryshuar “nëpunës civil”
1.	***** <i>Përgjegjës i Departamentit të Menaxhimit të Cilësisë dhe Shërbimeve</i>	Vendim nr. 19, dt.18.12.1997	Akt deklarimi nr.1198/51, dt.30.10.2014
2.	***** <i>Specialist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Vendimi nr. 30, dt.12.01.2005	Akt deklarimi nr.1198/54, dt.30.10.2014
3.	***** <i>Specilist Metrolog</i>	Urdhër nr. 9, dt.13.03.2009	Akt deklarimi nr.1198/55, dt.30.10.2014
4.	***** <i>Specialist i Pritjes së Mostrave</i>	Vendim nr. 26, dt.01.12.2004	Akt deklarimi nr.1198/56, dt.30.10.2014
5.	***** <i>Specilist i Pritjes së Mostrave</i>	Urdhër nr. 4, dt.16.02.2009	Akt deklarimi nr.1198/57, dt.30.10.2014
6.	***** <i>Specialist (zbatues)</i>	Urdhër nr.1, dt.04.01.2007	Akt deklarimi nr.1198/58, dt.30.10.2014
7.	***** <i>Përgjegjëse Sektori</i>	Urdhër nr. 18/1, dt. 02.05.2011	Akt deklarimi nr.1198/50, dt.30.10.2014
8.	***** <i>Specialist (Juriste)</i>	Urdhër nr. 7, dt. 27.01.2012	Akt deklarimi nr.1198/59, dt.30.10.2014
9.	***** <i>Përgjegjëse Departamenti</i>	Vendim nr.10, dt.16.03.2004	Akt deklarimi nr.1198/38, dt.30.10.2014
10.	***** <i>Specialist Bakterolog (me grada/tituj shkencor)</i>	Ka filluar në institucion në datën 24.05.1996	Akt deklarimi nr.1198/36, dt.30.10.2014
11.	***** <i>Specialist Bakterolog (me grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 34, dt.25.07.2005	Akt deklarimi nr.1198/35, dt.30.10.2014
12.	***** <i>Specialist Bakterolog (me grada/tituj shkencor)</i>	Vendim nr.19, dt.18.12.1997	Akt deklarimi nr.1198/34, dt.30.10.2014
13.	***** <i>Përgjegjëse Sektori</i>	Sipas librezës së punës ka filluar si <i>Shefe Sektori</i> në dt.16.11.2009	Akt deklarimi nr. 1198/33, dt.30.10.2014
14.	***** <i>Specialist (me grada/tituj shkencor)</i>	Ka filluar ne institucion Vendimin nr.12, dt.23.05.1996	Akt deklarimi nr.1198/32 dt.30.10.2014
15.	***** <i>Specialist (me grada/tituj</i>	Urdhër nr. 3, dt.06.01.2003	Akt deklarimi nr.1198/31, dt.30.10.2014

	<i>shkencor)</i>		
16.	***** <i>Specialist Iktiopatolog</i>	Urdhër nr. 12 dt.16.07.2007	Akt deklarimi nr.1198/30, dt.30.10.2014
17.	***** <i>Specialist (me grada/tituj shkencor)</i>	Vendim nr. 9, dt.09.10.2002	Akt deklarimi nr.1198/29, dt.30.10.2014
18.	***** <i>Specialist (me grada/tituj shkencor)</i>	Ka filluar në institucion në datën 02.06.1989	Akt deklarimi nr.1198/28, dt.30.10.2014
19.	***** <i>Përgjegjës Sektori</i>	Kontratë punë e datës 12.02.2008	Akt deklarimi nr.1198/23, dt.30.10.2014
20.	***** <i>Specialist zbatues</i>	Vendimi nr. 26, dt.16.12.1994	Akt deklarimi nr.1198/22, dt.30.10.2014
21.	***** <i>Specialist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 12, dt.06.05.2009	Akt deklarimi nr.1198/47, dt.30.10.2014
22.	***** <i>Specilist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 21 dt.28.08.2008	Akt deklarimi nr.1198/46, dt.30.10.2014
23.	***** <i>Zëvendës titullar/Përgjegjës Departamenti</i>	(punonjës ekzistues) Urdhër nr. 234, datë 24.09.2013 në këtë pozicion	Akt deklarimi nr.648/6, dt.20.02.2015 konfirmohet TND, si <i>Drejtor i ISUV</i> dhe pas dorëheqjes kalon në pozicionin aktual
24.	***** <i>Përgjegjës Sektori</i>	Urdhër nr. 33, dt.17.11.2008	Akt deklarimi nr.1198/19, dt.30.10.2014
25.	***** <i>Specialist Mikrobiolog (me grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 14, dt.12.08.2002	Akt deklarimi nr.1198/18, dt.30.10.2014
26.	***** <i>Specialist Mikrobiolog (pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 2, dt.03.01.2013	Akt deklarimi nr.1198/17, dt.30.10.2014
27.	***** <i>Specialist plantolog (pa grada/tituj shkencor)</i>	Ka filluar në institucion me Vendimi nr. 31, dt.21.01.2005	Akt deklarimi nr.1198/14, dt.30.10.2014
28.	***** <i>Specialist biotoksikolog (me grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr.12, dt.16.07.2007	Akt deklarimi nr.1198/15, dt.30.10.2014
29.	***** <i>Specialist kimist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Kontratë pune 16.08.2007	Akt deklarimi nr.1198/39, dt.30.10.2014
30.	***** <i>Përgjegjës Sektori</i>	Kontratë individuale e datës 02.05.2011	Akt deklarimi dek.nr.1198/12 dt.30.10.2014
31.	***** <i>Përgjegjëse Sektori</i>	Urdhër nr. 48, dt.27.07.2012	Akt deklarimi nr.1198/10, dt.30.10.2014
32.	***** <i>Specialist kimist(pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr.32 dt.13.06.2005	Akt deklarimi nr.1198/27, dt.30.10.2014
33.	***** <i>Specialist kimist (pa grada/tituj shkencor)</i>	(punonjës ekzistues) Urdhër nr. 10/1, dt. 27.01.2014 kalon në këtë pozicion	Akt deklarimi nr.1198/26, dt.30.10.2014

34.	***** <i>Specialist kimist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Kontratë individuale pune e datës 16.08.2007	Akt deklarimi nr.1198/25, dt.30.10.2014
35.	***** <i>Specialist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 13, dt.22.02.2010	Akt deklarimi nr.1198/7, dt.30.10.2014
36.	***** <i>Përgjegjëse e Sektorit të Financës</i>	Urdhër nr. 26, dt.16.04.2012	Akt deklarimi nr.1198/68, dt.13.01.2015

Pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, për **36 punonjësit** e deklaruar me statusin e punësimit **“Nëpunës civil”**, vërehet se:

- Procedurat e deklarimit të statusit të punësimit **“Nëpunës civil”**, për këta punonjës janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4 të ligjit nr.152/2013, **“Për nëpunësin civil”**, i ndryshuar.
- Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit, nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet përkatëse të punës dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, **“Për nëpunësin civil”**, i ndryshuar, **kanë patur më shumë se një vit vjetërsi**, në detyrën që mbanin në datën **26.02.2014**. Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse (DAP), ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si **“nëpunës civilë”**, nëpërmjet vendimeve përkatëse të nxjerra, në muajin Tetor 2014, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **aneksin nr. 1 – “Nëpunës civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”**, i cili është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, në gjithë rastet e përmendura më sipër, njësia përgjegjëse (DAP), ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civilë, pasi ata i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, **“Për nëpunësin civil”**, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

➤ **Punonjës aktualë të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u morën në analizë të detajuar të gjitha rastet, kur nga ana e njësisë përgjegjëse (DAP) është deklaruar statusi i punësimit për punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë **më pak se 1 vit**.

Nominalisht, bëhet fjalë për punonjësit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 2 - “Nëpunës civil në periudhë prove”

Nr.	Emër Mbiemër <i>Emërtesa e pozicionit të punës</i>	Akti i emërimit <i>(Nr/data e aktit)</i>	Akti i deklarimit të statusit të punësimit sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” , i ndryshuar “nëpunës civil në periudhë prove”
-----	-------------------------------------------------------	---------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

1.	***** <i>Përgjegjëse Sektori</i>	Urdhër nr. 66, dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/52, dt.30.10.2014
2.	***** <i>Specialist IT</i>	Urdhër nr. 79 dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/49, dt.30.10.2014
3.	***** <i>Përgjegjëse Sektori</i>	Urdhër nr. 73, dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/37, dt.30.10.2014
4.	***** <i>Specialist zbatues</i>	Urdhër nr. 94 dt.04.12.2013 Urdhër nr.63 dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/21, dt.30.10.2014
5.	***** <i>Specialist zbatues</i>	Urdhër nr. 66, dt. 31.10.2013 Urdhër nr. 68, dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/20, dt.30.10.2014
6.	***** <i>Përgjegjës Departamenti</i>	Urdhër nr. 5, dt.01.02.2008 Urdhër nr. 75, dt.25.02.2014 <i>Pergj Departamenti</i>	Akt deklarimi nr.1198/53, dt.30.10.2014
7.	***** <i>Përgjegjëse Sektori</i>	Urdhër nr. 59, dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/48, dt.30.10.2014
8.	***** <i>Përgjegjëse Sektori</i>	Urdhër nr.56, dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/44, dt.30.10.2014
9.	***** <i>Specialist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 67, dt.31.10.2013 Urdhër nr. 55, dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/44, dt.30.10.2014
10.	***** <i>Specialist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 70, dt. 08.11.2013 Urdhër nr. 58, dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/43, dt.30.10.2014
11.	***** <i>Përgjegjëse Sektori</i>	Urdhër nr.76, dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/13, dt.30.10.2014
12.	***** <i>Specialist kimist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 71 dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/16 dt.30.10.2014
13.	***** <i>Përgjegjëse Departamenti</i>	Urdhër nr. 26, dt.01.10.2008 Urdhër nr. 80, dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/42, dt.30.10.2014
14.	***** <i>Përgjegjëse Sektori</i>	Urdhër nr. 52, dt.25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/41, dt.30.10.2014
15.	***** <i>Specialist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 12 dt.27.01.2014	Akt deklarimi nr.1198/11 dt.30.10.2014
16.	***** <i>Përgjegjës Sektori</i>	Urdhër nr. 91, dt. 25.02.2014	Akt deklarimi nr.1198/8, dt.30.10.2014

Pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, për **16 punonjësit** e deklaruar me statusin e punësimit **“Nëpunës civil në periudhë prove”**, vërehet se:

- Procedurat e deklarimit të statusit të punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, për të gjithë punonjësit e përcaktuar në këtë kategori janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit, nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet përkatëse të punës dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, *kanë patur më pak se një vit vjetërsi*, në detyrën që mbanin në datën 26.02.2014.
- Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse (DAP), ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si “*nëpunës civilë në periudhë prove*”, nëpërmjet vendimeve përkatëse të nxjerra, në muajin Tetor 2014, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **aneksin nr. 1** – “*Nëpunës civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)*”, i cili është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Edhe për këto raste, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse (DAP), ka vepruar drejt në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove, pasi ata i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 4, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij. Konstatohet se, për të gjitha këto raste, tashmë ka përfunduar periudha e proves dhe është realizuar programi i trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civilë. Në dosjet e këtyre nëpunësve janë të administruara çertifikatat përkatëse të lëshuara nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA), vendimi i eprorit direkt, shoqëruar me mendimin e nëpunësit civil më të vjetër. Kjo procedurë kishte përfunduar duke u finalizuar me aktet përkatëse të konfirmimit të nëpunësit, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

➤ **Në 3 raste, është vendosur mosdeklarim i statusit të punësimit**

Nga këqyrja e akteve dhe analiza që i është bërë rasteve të mosdeklarimit të statusit të punësimit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, konstatohet se, njësia përgjegjëse (DAP), në **3 raste**, nuk ka deklaruar statusin e punësimit, për punonjësit në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, për shkak se, ata nuk përmbushnin kriterin e nivelit arsimor (grada/tituj shkencorë).

Nominalisht, bëhet fjalë për punonjësit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 3 “*Punonjës për të cilët nuk është deklaruar statusi i punësimit*”

Nr.	Emër Mbiemër <i>Emërtesa e pozicionit të punës</i>	Akti i emërimit <i>(Nr/data e aktit)</i>	Akti i deklarimit të statusit të punësimit sipas ligjit nr.152/2013, “ <i>Për nëpunësin civil</i> ”, i ndryshuar

1.	***** <i>Specialist (me grada/tituj shkencor)</i>	Ka filluar në institucion që nga viti 1989	Mosdeklarimi i statusit, i është njoftuar me aktin nr. 1198/60, dt. 30.10.2014
2.	***** <i>Specialist (me grada/tituj shkencor)</i>	Ka filluar në institucion që nga viti 1983	Mosdeklarimi i statusit, i është njoftuar me aktin nr. 1198/60, dt. 30.10.2014
3.	***** <i>Specialist (me grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr.21, dt.10.12.2006	Mosdeklarimi i statusit, i është njoftuar me aktin nr. 1198/60, dt. 30.10.2014

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **aneksin nr. 1** – “Nëpunës civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, i cili është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konstatohet se, njësia përgjegjëse (DAP) për këto raste, ka nxjerrë aktin e mosdeklarimit të statusit të punësimit me shkresën nr. 1198/60 prot., datë 30.10.2014, duke arsyetuar se këta punonjës nuk i përmbushin kërkesat ligjore për t`u deklaruar si nëpunës civil.

Ndërkohë, në lidhje me këtë moment, nëpërmjet shkresës me nr. 790 prot., datë 04.12.2014, “Kërkesë për rishikimin e DAP, argumenta në mbështetje të kërkesës”, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë i ka kërkuar njësisë përgjegjëse (DAP), rishikimin e statusit të punësimit për 3 punonjësit (*****, ***** dhe *****) e përmendur më sipër, me arsyetimin se: “Largimi i këtyre punonësve do të dëmtonte punën aktuale të institucionit, sepse ata mbartin ekspertiza të spikatura në formimin e tyre. Ata janë produkt i një pune të ndërtuar në vite dhe do të duhej kohë dhe investim për t`u zëvendësuar. Konkretisht,

- *****, si një punonjës/specialiste e vjetër e institutit që nga viti 1989.
- *****, si një punonjës/specialiste e vjetër e institutit që nga viti 1983.
- *****, si një specialiste me një ekspertizë unike në fushën e saj (farmaceutike prej 24 vitesh në këtë fushë)”.

Njëkohësisht, me këtë kërkesë, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, me shkresën nr.799 prot., datë 11.12.2014, “Kërkesë për rishikimin e strukturës së ISUV në funksion të shfrytëzimit maksimal të kapaciteteve aktuale”, i ka kërkuar Ministrin të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, rishikimin e strukturës së tij aktuale, për të shfrytëzuar maksimalisht burimet njerëzore të tij.

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, me shkresën nr. 8596/1 prot., datë 16.12.2014, “Kthim përgjigje për rishikimin e strukturës së ISUV”, është shprehur dakord me mundësinë për rishikimin e strukturës së ISUV, duke dërguar për miratim strukturën e rishikuar të ISUV. Në këtë projektstrukturë është parashikuar edhe risistemimi i pozicioneve të punës të punonjësve të përmendur më sipër. Struktura e re e ISUV-it, është miratuar me Urdhër nr. 55, datë 22.04.2015, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”, (kjo situatë është e sqaruar në Kreun VII, të materialit).

Në këto rrethana, ndërkohë që Departamenti i Administratës Publike ishte duke shqyrtuar rastin në fjalë dhe këta punonjës trajtoheshin me leje administrative, ka ndryshuar struktura dhe këta punonjës janë sistemuar në pozicione pune ku i plotësonin kërkesat për vendin e punës.

- **Në 2 raste, është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil në kundërshtim me kërkesat e ligjit (afati kohor i punësimit në pozicionin e shërbimit civil, më i vogël se 1 vit)**

Gjatë procesit të verifikimit, konstatohet se, njësia përgjegjëse (DAP), në **2 raste**, ka deklaruar statusin e punësimit si nëpunës civil, në kundërshtim me ligjin, për shkak se, 2 punonjës ishin të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më pak se 1 vit.

Nominalisht, bëhet fjalë për punonjësit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 4 - "Punonjës të deklaruar si nëpunës civil në kundërshtim me ligjin"

Nr.	Emër Mbiemër <i>Emërtesa e pozicionit të punës</i>	Akti i emërimit <i>(Nr/data e aktit)</i>	Akti i deklarimit të statusit të punësimit sipas ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar
1.	***** <i>Specialist kimist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 22, dt.29.04.2013	Akt deklarimi si nëpunës civil me nr.1198/40, dt. 30.10.2014 si NC
2.	***** <i>Specialist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 48, dt.19.08.2013	Akt deklarimi si nëpunës civil me nr.1198/9, dt. 30.10.2014 si NC

- ***** emëruar në pozicionin e punës, "Specialist kimist (pa grada/tituj shkencor), në Sektorin e Toksikologjisë dhe Mbetjeve, në Departamentin e Toksikologjisë, Monitorimit të Mbetjeve dhe Cilësisë".

Pas verifikimit të dokumentacionit rezultoi se, kjo punonjëse ka filluar punë në institucion me Urdhrin nr. 22, datë 29.04.2013, të titullarit të institucionit. Konstatohet se për të, është deklaruar statusi i punësimit si "nëpunës civil", me aktin nr. 1198/40, datë 30.10.2014, të njësisë përgjegjëse (DAP). Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjëses, rezultoi se, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarimin e statusit të punësimit për këtë rast, pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjëse, në pozicionin ku e ka gjetur fillimi i efekteve juridike të ligjit për shërbimin civil, ka filluar në datën 29.04.2013. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, (data 26.02.2014), kjo punonjëse kishte më pak se 1 vit në atë pozicion pune, e për këtë arsye duhet të deklarohet "nëpunës civil në periudhë prove".

- ***** emëruar në pozicionin e punës, "Specialist (pa grada/tituj shkencor), në Sektorin e Vlerësimit të Cilësisë së Ushqimeve, në Departamentin e Toksikologjisë, Monitorimit të Mbetjeve dhe Cilësisë".

Pas verifikimit të dokumentacionit rezultoi se kjo punonjëse ka filluar punë në institucion me Urdhrin nr. 48, datë 19.08.2013, të titullarit të institucionit. Konstatohet se për të, është deklaruar statusi i punësimit si "nëpunës civil", me aktin nr. 1198/9, datë 30.10.2014, të njësisë përgjegjëse (DAP). Nga verifikimi i dokumentacionit të

administruar në dosjen personale të punonjësës, rezultoi se, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarin e statusit të punësimit për këtë rast, pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjëse, në pozicionin ku e ka gjetur fillimi i efekteve juridike të ligjit për shërbimin civil, ka filluar në datën 19.08.2013. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, (*data 26.02.2014*), kjo punonjëse kishte më pak se 1 vit në atë pozicion pune, e për këtë arsye duhet të deklarohej "*nëpunës civil në periudhë prove*".

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse (DAP) për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar dhe nenit 111, 113, të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", në lidhje me rastet e deklarin të statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin, për shkak të mosrespektimit të afatit kohor të punësimit në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, duhet të veprojë si më poshtë:

- Të anulohet aktin administrativ nr. 1198/40, datë 30.10.2014, për deklarin e statusit të punësimit për nëpunësen *****, duke e ndryshuar pozicionimin e saj në raport me shërbimin civil, nga "*nëpunës civil*", në "*nëpunës civil në periudhë prove*", për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, (*data 26.02.2014*), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.
- Të anulohet aktin administrativ nr. 1198/9, datë 30.10.2014, për deklarin e statusit të punësimit për nëpunësen *****, duke e ndryshuar pozicionimin e saj në raport me shërbimin civil, nga "*nëpunës civil*", në "*nëpunës civil në periudhë prove*", për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, (*data 26.02.2014*), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.
- Njësia e burimeve njerëzore e ISUV-it, duhet të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës për punonjëset e mësipërme, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësja gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit ose jo, në përfundim të periudhës së provës dhe të njoftohet për këtë vendim njësia përgjegjëse (DAP). Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës dhe plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (*të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA)*).

- Në 2 raste, nuk është deklaruar statusi i punësimit, për shkak se janë shkëputur marrëdhëniet e punës përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit (pension pleqërie)

Në këtë rast, bëhet fjalë për punonjësit, *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Parazitologjisë Mykologjisë dhe Sëmundjeve të Peshkut” dhe *****, në pozicionin e punës, “Specialist kimist pa grada e tituj në Sektorin e Toksikologjisë dhe Mbetjeve”.

Për të dy rastet e mësipërme nuk është deklaruar statusi i punësimit, pasi këta punonjës kanë shkëputur marrëdhëniet e punës për shkak të plotësimit të moshës së pensionit të plotë të pleqërisë, përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit (data 30.10.2014).

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **aneksin nr. 1** – “Nëpunës civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, i cili është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Në këtë rast Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse (DAP), ka vepruar në mbështetje të kërkesave të nenit 65, shkronja “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, e në rastin konkret, për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë.

- Në 4 raste, është deklaruar statusi i punësimit, me kushtin që, brenda një afati 2 vjeçar, të plotësohet kritëri i diplomës

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u morën në analizë të detajuar **4 raste**, kur nga ana e njësisë përgjegjëse (DAP) është deklaruar statusi i punësimit për punonjës ekzistues, me kushtin e pritjes për një periudhë 2 vjeçare.

Nominalisht, bëhet fjalë për punonjësit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 5 - “Nëpunës civil në periudhë pritje 2-vjeçare”

Nr.	Emër Mbiemër <i>Emërtesa e pozicionit të punës</i>	Akti i emërimit <i>(Nr/data e aktit)</i>	Akti i deklarimit të statusit të punësimit sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar
1.	***** <i>Specialist biotoksikolog (me grada/tituj shkencor)</i>	Vendim nr. 1, dt. 13.02.2002	Shkresa e DAP nr. 324, dt.11.02.2015
2.	***** <i>Specialist kimist (pa grada/tituj shkencor)</i>	Kontratë individuale të punës të datës 26.12.2007	Shkresa e DAP nr. 324, dt.11.02.2015

3.	***** <i>Specialist kimist (me grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. 19, dt.01.10.2007	Shkresa e DAP nr. 324, dt.11.02.2015
4.	***** <i>Specialist (me grada/tituj shkencor)</i>	Urdhër nr. extra dt.15.07.2011	Shkresa e DAP nr. 1198/66, dt. 13.01.2015

Njësia përgjegjëse (DAP) pas verifikimit të dosjeve personale të tyre, si dhe pas njohjes me përmbajtjen e shkresës me nr. 402 prot., datë 17.06.2014, “*Informacion për punonjësit e ISUV*”, dërguar nga institucioni, ku ndër të tjera sqarohet se ***** , ***** , ***** dhe ***** , ishin në proces doktrature, ka deklaruar statusin e punësimit për ta me kushtin, që për një periudhë 2 vjeçare, këta punonjës duhet të plotësojnë kriterin e diplomës (në lidhje me fitimin e titullit dhe gradës shkencore) sipas përshkrimit të pozicionit të punës.

Kjo ishte një zgjidhje e gjetur nga njësia përgjegjëse (DAP), duke u ndodhur në kushtet specifike që ka Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, si një rast i veçantë në lidhje me çdo institucion tjetër të administratës shtetërore, për shkak të nivelit të lartë të përgatitjes që kërkon puna në pozicione të caktuara, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **aneksin nr. 1** – “*Nëpunës civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)*”, i cili është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Përfundimi i ciklit të doktoraturës, sipas ligjit për arsimin e lartë, kërkon një kohë më të gjatë se dy vjet dhe për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse (DAP), ka vepruar drejt ndodhur në këto kushte specifike të institucionit të mbikëqyrur, në përputhje me nenin 67, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në lidhje me shtyrjen e afatit të deklarimit të statusit të punësimit për këta punonjës.

► **Procesi i deklarimit të statusit të punësimit në raport me afatet ligjore:**

Vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (ndryshuar me vendimin nr. 532, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave; ndryshuar me vendimin nr. 627, datë 24.09.2014 të Këshillit të Ministrave)*, ka parashikuar procedurat e hollësishme që duhet të kryejë njësia përgjegjëse për të realizuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë si dhe afatin brenda të cilit duhet të përfundojë i gjithë ky proces. Në Kreun IV, të vendimit si më sipër, është përcaktuar se “*Procedura e deklarimit të statusit të punësimit përfundon jo më vonë se 120 (njëqind e njëzetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. ... Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk mund të jetë më vonë se data 30 tetor 2014 ...*”.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur, i ka përfunduar

procedurat e deklarimit të statusit të punësimit *në datën 30.10.2014*, pra brenda afatit të vendosur në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Të dhënat që pasqyrojnë realizimin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, siç janë: akti për fillimin e marrëdhënieve të punës në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë; akti i deklarimit të statusit të punësimit “*Nëpunës civil*” apo “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, si dhe të dhënat lidhur me përmbushjen e detyrimeve të periudhës së provës, janë të pasqyruara në mënyrë analitike në anekset nr. 1 dhe nr. 2 të hartuara nga grupi i punës dhe që i bashkëlidhen raportit si pjesë e tij.

II. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës

Nëpunësit civil që emërohen për herë të parë në shërbimin civil i nënshtrohen një periudhe prove. Afati i periudhës së provës si dhe detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi dhe institucioni përgjatë kësaj periudhe dhe në përfundim të saj, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Kreun V, të vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë kohës që ka qenë në fuqi ky akt nënligjor); si dhe në Kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Ndërsa për nëpunësit dhe punonjësit ekzistues, (nëpunësit dhe punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në funksione të shërbimit civil) dhe që kishin një periudhë punësimi më të vogël se një vit, në pikën 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është përcaktuar se për ta zbatohet neni 24, i këtij ligji dhe se periudha e provës fillon nga fillimi i efekteve juridike të ligjit.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, u verifikua tërësia e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve civilë, të cilët i janë nënshtruar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit me institucionin.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, gjatë vitit 2015 kanë përfunduar periudhën e provës **16** nëpunës ekzistues. Këta punonjës në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit (*data 26.02.2014*) e kishin periudhën e punësimit në të njëjtin vend, më pak se një vit dhe përfituan

statusin e punësimit sipas nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për të **16 rastet** e detajuara në Tabelën nr. 2, “Nëpunës civil në periudhë prove”, trajtuar më sipër në këtë material, rezulton se :

- Gjatë periudhës së provës, nëpunësit kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe në fund të trajnimit i janë nënshtruar testimit. Bazuar në pikën 2, të Kreut IV, të vendimit nr. 138, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimin e nëpunësve civil”, i ndryshuar, trajnimi për periudhën e provës pranë ASPA-s konsiderohet i ndjekur me sukses nëse nëpunësi merr të paktën 50 % të pikëve në testim.
- Nëpunësve iu është bërë vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore.
- Në përfundim të periudhës së provës, si dhe pasi është marrë mendimi i nëpunësit civil më të vjetër, titullari i institucionit ka finalizuar këtë proces duke nxjerrë aktet e konfirmimit për çdo nëpunës civil.
- Vendimet e konfirmimit, pas përfundimit të periudhës së provës, i janë njoftuar Departamentit të Administratës Publike, i cili paraqitet në cilësinë e njësisë përgjegjëse për këtë institucion dhe si organi kompetent për administrimin e Regjistrisë Qendrore të Personelit.

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, nga ana e institucionit është vepruar drejt në lidhje me përmbushjen e kërkesave ligjore të periudhës së provës, të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet e konfirmimit i ka dërguar pranë njësisë përgjegjëse (DAP).

III. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, u verifikuan përshkrimet e punës, për të vlerësuar nëse janë respektuar rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë të përcaktuara rastet kur një institucion pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë përshkrimet e punës, procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen si dhe nëpunësit përgjegjës në këtë proces.

Më konkretisht, vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, në Kreun IV, “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës” (pika 14), përcakton se:

“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.

Përshkrimi i punës hartohet nga analisti i punës, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës dhe në rastet kur analisti i punës mungon në strukturën e institucionit, për të cilin ka lindur nevoja e hartimit të përshkrimeve të punës, ky proces realizohet nga drejtuesi i njësisë organizative për menaxhimin e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës.

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, për periudhën objekt kontrolli, evidentohen dy momentet që kanë diktuar nevojën e hartimit të përshkrimeve të reja të punës, ashtu si i përmendëm më sipër.

Së pari, fillimi i efekteve juridike të legjislacionit të ri të shërbimit civil dhe përfshirja e institucionit në fushën e tij të veprimit (*ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij*), kushtëzon edhe hartimin e përshkrimeve të punës, si kërkesë specifike ligjore.

Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, në Kreun VI, “Dispozita tranzitore”, pika 40, ka parashikuar që, të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil, duhet të përfundojnë hartimin e përshkrimit të punës, deri në datën 1 korrik 2014.

Së dyti, institucioni ka kaluar në një proces ristrukturimi, pas përfshirjes së tij në fushën e shërbimit civil.

Nga verifikimi rezulton se në këtë institucion, përshkrimet e punës janë hartuar sipas formatit standard të miratuar dhe janë nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, eprori direkt dhe nga nëpunësi civil që punon në pozicionin për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, në përputhje me pikën 4.2.10, të udhëzimit nr. 2, datë 07.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Por, nga ana tjetër, në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, është parashikuar se Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, kthen për rishikim përshkrimet e punës për pozicionet respektive, në rast se vëren se ato, nuk janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.

Mbështetur në sa parashikohet në këtë pikë, nënvizojmë se, e drejta e Departamentit të Administratës Publike, për të rikthyer për rishikim përshkrimet e punës, nënkupton edhe

detyrimin e këtij organi për të aprovuar në mënyrë shkresore rregullshmërinë e përshkrimeve të punës, duke e bërë me dije zyrtarisht institucionin e mbikëqyrur dhe Sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë së linjës, se përshkrimet e punës janë në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, me qëllim që ata të vijojnë me procedurën e depozitimit të tyre pranë Departamentit të Administratës Publike.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në këtë rast u konstatua se, procedura e bashkëpunimit ndërmjet strukturave/nëpunësve përgjegjës për realizimin e këtij procesi, që janë analist pune, epror direkt i pozicionit përkatës/Departamenti i Administratës Publike, janë realizuar vetëm në formë elektronike. Përshkrimet e punës janë plotësuar në sistemin elektronik, të administruar nga njësia përgjegjëse (*DAP-i*). Ndërmjet këtij sistemi, njësia përgjegjëse ka asistuar nëpunësit e ngarkuar për hartimin e përshkrimeve të punës duke iu dhënë sugjerimet e nevojshme teknike. Në vijim, i gjithë procesi rezultoi të jetë zhvilluar në format elektronik dhe në përfundim, përshkrimet e punës janë printuar nga sistemi dhe janë nënshkruar. Bashkëpunimi në sistemin elektronik, ndërmjet analistit të punës dhe specialistit të *DAP-it* ka të bëjë vetëm me fazën e krijimit apo hartimit të përshkrimeve të punës që është faza e parë e këtij procesi.

Në këtë rast, konstatimet e grupit të punës, në lidhje me dokumentimin e procesit, kanë të bëjnë me fazat e mëtejshme të tij, të tilla si, dhënia e mendimit të njësisë përgjegjëse lidhur me përputhshmërinë e përshkrimeve të punës me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar dhe fazën e fundit, që është administrimi i përshkrimeve të punës, ku një kopje e dokumentit përfshihet në dosjen e personelit të çdo nëpunësi, (*në rastin e vendeve të lira një kopje e përshkrimit të punës për secilin pozicion i bashkëngjitet planit të rekrutimit*), një kopje e përshkrimeve të punës depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike. Në këtë mënyrë përshkrimet e punës bëhen pjesë e akteve rregullative në bazë të të cilave është i organizuar dhe funksionon institucioni, siç janë, struktura dhe organika në fuqi e institucionit, rregullorja e brendshme e institucionit etj.

Në lidhje me përmbushjen e kërkesave të vendit të punës, nga përmbajtja e aktit të përshkrimit të punës, konstatohet se, në ndarjen "*Kërkesa të posaçme*", janë përcaktuar kërkesat specifike të vendit të punës në lidhje me nivelin e edukimit dhe fushën kryesore të studimeve; përvojën në punë e përcaktuar në terma kohorë dhe në pozicionin përkatës; si dhe njohuritë e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për përmbushjen e funksionit të pozicionit të punës.

Nga të dhënat e administruara, të cilat pasqyrohen në aneksin nr. 2 : "*Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë*", bashkëlidhur raportit, rezultoi se nëpunësit i plotësojnë këto kërkesa.

Konkluzion: Në lidhje me ç`ka u analizua më sipër, Komisioneri vlerëson se, institucioni i mbikëqyrur duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm:

- Duhet t'i kërkojë njësisë përgjegjëse, (*DAP*), që të japë mendimin lidhur me përshkrimet e punës, nëse janë hartuar në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.

- Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse, përshkrimet e punës t'i përcillen për miratim Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë së linjës, i cili finalizon këtë proces duke nënshkruar përshkrimet e punës në ndarjen përkatëse, pasi nënshkrimi i formularit të përshkrimit të punës nga ana e tij, nga eprori direkt dhe nëpunësi civil për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, është një detyrim specifik, i parashikuar në pikën 18, 19 dhe 20, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.

- Në përfundim të procedurave si më sipër, një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkuara, duhet të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike. Procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës është një procedurë administrative, kryerja e së cilës kërkon respektimin e rregullave dhe të afateve të vendosura në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".

- Sjellim në vëmendje të njësive përgjegjëse dhe njësive së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, se në çdo rast, procedurat administrative që kanë lidhje me menaxhimin e shërbimit civil dhe që janë kryer në mënyrë elektronike, t'i materializojnë ato edhe në formë shkresore, duke respektuar mënyrën dhe elementët që duhet të përmbajë kopja në letër e dokumentit elektronik, të përcaktuara në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik", i ndryshuar, ligjin nr.10273, datë 29.04.2010, "Për dokumentin elektronik", si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 31.12.2012, të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, "Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike".

IV. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit shërbimin civil

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, në të cilin është përcaktuar se, mbikëqyrja përfshin ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, për periudhën kohore nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e në vijim, u verifikua planifikimi i nevojave për rekrutim në shërbimin civil për vitin 2015 dhe për vitin 2016.

Konstatohet se, planifikimi i nevojave për rekrutim në shërbimin civil, në institucionin e mbikëqyrur, është realizuar duke u bazuar në përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil".

Mbështetur në këto dispozita, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka përgatitur planin e nevojave për rekrutim për vitin 2015 dhe vitin 2016, të cilin ja ka bërë të njohur njësive përgjegjëse të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, e cila ka mbajtur një korrespondencë "on-line", me Departamentin e Administratës Publike, gjë e cila është pasqyruar në vendimin nr. 169, datë 25.02.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2015".

V. Rastet e rekrutimeve, lëvizjeve paralele, ngritjeve në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

Për periudhën objekt mbikëqyrje, u konstatua **1 rast**, i emërimit nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil, e parashikuar në nenin 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe në vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe **1 rast**, i emërimit nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, e parashikuar në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe vendimin nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

- Pranimi në shërbimin civil në nivel ekzekutiv

Në këtë rast, bëhet fjalë për procedurën e rekrutimit, e cila ka shpallur fituese punonjësen *****, emëruar në pozicionin e punës, “Specialist Kimist (pa grada/tituj shkencorë) në Sektorin e Toksikologjisë dhe Mbetjeve”, me aktin nr. 4, datë 18.01.2016, të Departamentit të Administratës Publike.

- Ngritje në detyrë

Në lidhje me këtë procedurë, është evidentuar **1 rast** dhe bëhet fjalë për punonjësen *****, emëruar në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Sektorit të Parazitologjisë Mykologjisë dhe Sëmundjeve të Peshkut”, me aktin nr. 6404, datë 22.12.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, në të dyja rastet, procedura e rekrutimit është kryer nga njësia përgjegjëse, që në këtë rast, është Departamenti i Administratës Publike, sipas parashikimeve në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

VI. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes ose për shkak të ligjit dhe pezullimit

Nga verifikimi i dokumentacionit që lidhet me institutin e lirimit nga shërbimi civil, konstatohet se për periudhën objekt mbikëqyrje, në institucionin e kontrolluar, evidentohen disa raste, të cilët janë sqaruar më poshtë:

- Në **1 rast**, nëpunësi ka paraqitur kërkesë me shkrim për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në bazë të nenit 66, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësin *****, në pozicionin e punës, “Titullar i Institucionit”, liruar sipas institutit të dorëheqjes, me Urdhrin nr. 252, datë 22.05.2014.
- Në **1 rast**, konstatohet largim nga shërbimi civil për shkak të masës disiplinore, e cila është aplikuar në bazë të nenit 58/ç, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe konkretisht bëhet fjalë për punonjësen *****, nëpunës civil në

pozicionin e punës, “*Specialist Kimist (pa grada/tituj shkencor)*”, sipas Vendimit nr. 749, datë 21.11.2014.

➤ Në **6 raste**, punonjësit janë liruar pasi kanë mbushur moshën e pensionit të plotë të pleqërisë, në bazë të nenit 65/c, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, nëpunës civil në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Virologjisë*”, liruar për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, me urdhrin nr. 54/13, datë 12.09.2016.
2. *****, nëpunës civil në pozicionin e punës, “*Përgjegjës Sektori në Sektorin e Parazitologjisë Mykologjisë dhe Sëmundjeve të Peshkut*”, liruar për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, me urdhrin nr. extra, datë 06.09.2014.
3. *****, nëpunës civil në pozicionin e punës, “*Përgjegjës Sektori në Sektorin e Prodhimit të Biopreparateve*”, liruar për shkak të mbushjes së moshës së pensionit me urdhrin nr. 10, datë 08.01.2016.
4. *****, nëpunës civil në pozicionin e punës, “*Specialist Kimist (pa grada/tituj shkencore) në Sektorin e Toksikologjisë dhe Mbetjeve*”, liruar për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, me urdhrin nr. 534, datë 26.08.2014.
5. *****, nëpunëse civile në pozicionin e punës, “*Specialist Kimist (pa grada/tituj shkencore) në Sektorin e Analizave të PMB dhe Monitorimit të Mbetjeve në Bimë*”, liruar për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, me shkresën nr. extra, datë 16.11.2014.
6. *****, nëpunës civil në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Barnave Veterinare*”, liruar për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, me urdhrin nr. 1, datë 10.07.2015.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në lidhje me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes, plotësimit të moshës së pensionit të plotë të pleqërisë ose për shkak të masës disiplinore, në bazë të nenit 66, pika 1, germa “*dh*”, nenit 65, pika 1, germa “*c*” dhe nenit 58, germa “*ç*”, e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

VII. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit)

Kriteret bazë mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të nëpunësit civil në një pozicion tjetër të shërbimit civil (*transferim i përkohshëm, arsyet e transferimit, kohëzgjatja e transferimit, transferimi i përhershëm, rastet kur zbatohet transferimi i përhershëm, transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*), janë përcaktimet e Kreut VIII, “*Transferimi në shërbimin civil*”, dispozitat ligjore nga neni 48 deri në nenin 52, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si dhe Udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016, i Departamentit të Administratës

Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo restrukturimit të institucionit”.

Gjatë procesit të verifikimit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, konstatohet se:

- Për periudhën objekt mbikëqyrje në institucionin e kontrolluar është zbatuar vetëm rasti i transferimit për shkak të restrukturimit të institucionit i parashikuar në nenin 50, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Ndërsa, transferimi i përkohshëm; transferimi i përhershëm për arsye të paaftësisë shëndetësore; transferimi i përhershëm për shmangien e konfliktit të interesit dhe transferimi në përfundim të afatit apo të zhdukjes së shkakut të pezullimit për shkak të plotësisë përfundimtar të pozicionit të mëparshëm të punës, si raste të përcaktuara në nenet 48, 51, 52 dhe nenin 56/1, të ligjit të sipërcituar, nuk rezultojnë të jenë zbatuar gjatë periudhës së mbikëqyrur.

a) Transferimi për shkak të restrukturimit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (apo ndryshimit të mënyrës së organizimit të institucionit)

Nga verifikimi i tërësisë së materialeve shkresore të vëna në dispozicion, si dhe vlerësimit të tyre në raport me ligjin vërejmë se:

Me urdhrin nr. 55, datë 22.04.2015 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”, është miratuar struktura dhe organika e re e institucionit, si dhe numri i përgjithshëm i punonjësve, gjithsej 99 punonjës. Gjithashtu, urdhri për miratimin e strukturës së re, ka shfuqizuar strukturën dhe organikën e mëparshme të institucionit, e cila ishte miratuar me urdhrin nr. 72, datë 17.02.2014 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”.

Nga krahasimi i dy strukturave konstatohet se:

Në momentin e restrukturimit, institucioni nuk ka ndryshim në numrin e përgjithshëm të punonjësve, i cili vazhdon të jetë **99** veta. Sipas natyrës së funksioneve që kryenin këta punonjës, situata ka mbetur e pandryshuar, pasi ndarja është si më parë, ku **35** pozicione pune, klasifikohen si funksione administrative dhe **64** pozicione pune, si pjesë e shërbimit civil.

Nga analiza e procesit të restrukturimit në këtë rast, rezultojnë se janë prekur vetëm emërtesa e pozicioneve të punës “*Specialist*”, nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, për shkak të riorganizimit të tyre.

Situata në lidhje me këtë grupim pozicionesh paraqitet si më poshtë:

- Nga **16** pozicione pune, “*Specialist (me grada/tituj shkrencorë)*”, rezultojnë **13** pozicione pune të tilla.
- Nga **18** pozicione pune, “*Specialist (pa grada/tituj shkrencor)*”, rezultojnë **22** pozicione pune të tilla.
- Nga **9** pozicione pune, “*Specialist*”, rezultojnë **8** pozicione pune të tilla.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, miratimi i strukturës së re, nuk është shoqëruar me pakësim të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës në shërbimin civil. Por, nga ana tjetër,

konstatohet një riorganizim i pozicioneve të punës dhe ndryshim i kërkesave specifike të pozicioneve që i përkasin kategorisë ekzekutive, i cili konsiston kryesisht tek emërtesa “*Specialist (pa grada/tituj shkencor)*”. Ky fakt, provon përfshirjen e institucionit në proces ristrukturimi dhe sjell nevojën për hartimin e përskrimeve të reja të punës, e për pasojë edhe ndryshimin e kritereve të veçanta të pozicioneve që kanë pësuar ndryshime.

b) Procedurat e ndjekura për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit

Për të verifikuar procedurat e ndjekura në kuadër të ristrukturimit, u kërkua nga institucioni dokumentacioni përkatës, nga shqyrtimi i të cilit, rezulton se:

Pas hyrjes në fuqi të strukturës dhe organikës së re, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike (DAP), me shkresën nr. 220 prot., datë 29.04.2015, nëpërmjet të cilës ka kërkuar nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit për këtë institucion.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me urdhrin nr. 29, datë 29.04.2015, “*Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë*”, ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit me këtë përbërje:

- Një përfaqësues i njësisë përgjegjëse (DAP), kryetar i komisionit, (***** me detyrë *Specialiste në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Politikave të Rekrutimit në Departamentin e Administratës Publike*).

- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, *****, anëtar, si nëpunësi më i lartë civil i institucionit qendror nga i cili varet ISUV.

- Drejtori i ISUV, *****, anëtar, si nëpunësi më i lartë civil i institucionit.

Kjo trupë kolegjiale mbështetur në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Kreun III, të vendimit nr. 171, datë 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*” (tashmë i shfuqizuar), pasi ka marrë në shqyrtim mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë, vendet e të cilëve prekeshin nga ristrukturimi, ka përgatitur propozimin me shkrim për transferimin e tyre në vendet e lira ekzistuese, të cilat me shkresën nr. 391 prot., datë 12.06.2015, i janë dërguar njësisë përgjegjëse (DAP).

Duke analizuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit për çdo nëpunës, rezulton se, për 9 nëpunës është propozuar sistemimi i tyre në vendet e krijuara brenda organikës së institucionit. Në këtë kategori punonjësish, përfshihen edhe rastet atipike, të cilat ishin ende në momentin e rivlerësimit të statusit të punësimit, nga ana e DAP, me kërkesën e institucionit. Këto raste janë trajtuar në mënyrë të veçantë në pikën I, gërma b, “*Procedura e deklaramentit të statusit të punësimit, për nëpunësit dhe punonjësit, që kryenin funksione në shërbimin civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar*”, të materialit.

Më konkretisht, për nëpunësit civilë vendet e të cilëve prekeshin nga ristrukturimi, Komisioni i Ristrukturimit, ka propozuar si më poshtë:

1. Punonjësja *****, të transferohet në pozicionin e punës, “Specialiste (pa grada/tituj shkencore) në Sektorin e Menaxhimit të Cilësisë në Departamentin e Menaxhimit të Cilësisë”.
2. Punonjësja *****, të transferohet në pozicionin e punës, “Specialiste (pa grada/tituj shkencore) në Sektorin e Menaxhimit të Cilësisë në Departamentin e Menaxhimit të Cilësisë”.
3. Punonjësja *****, të transferohet në pozicionin e punës, “Specialiste (me grada/tituj shkencore) në Sektorin e Produkteve të Peshkut dhe Monitorimit të Molusqeve në Departamentin Mikrobiologjisë Ushqimore dhe Monitorimit të Ujërave”.
4. Punonjësja *****, të transferohet në pozicionin e punës, “Specialiste (pa grada/tituj shkencore) në Sektorin e Toksitologjisë dhe Mbetjeve në Departamentin e Toksitologjisë Monitorimit të Mbetjeve dhe Cilësisë”.
5. Punonjësja *****, të transferohet në pozicionin e punës, “Specialiste (pa grada/tituj shkencore) në Sektorin e Toksitologjisë dhe Mbetjeve në Departamentin e Toksitologjisë Monitorimit të Mbetjeve dhe Cilësisë”.
6. Punonjësja *****, të transferohet në pozicionin e punës, “Specialiste (pa grada/tituj shkencore) në Sektorin e Vlerësimit të Cilësisë së Ushqimit në Departamentin e Toksitologjisë Monitorimit të Mbetjeve dhe Cilësisë”.
7. Punonjësja *****, të transferohet në pozicionin e punës, “Specialiste (pa grada/tituj shkencore) në Sektorin e Vlerësimit të Cilësisë së Ushqimit në Departamentin e Toksitologjisë Monitorimit të Mbetjeve dhe Cilësisë”.
8. Punonjësja *****, të transferohet në pozicionin e punës, “Specialiste (me grada/tituj shkencore) në Sektorin e Analizave të PMB dhe Monitorimit të Mbetjeve në Bimë në Departamentin e Toksitologjisë Monitorimit të Mbetjeve dhe Cilësisë”.
9. Punonjësja *****, të transferohet në pozicionin e punës, “Specialiste (pa grada/tituj shkencore) në Sektorin e Kontrollit të Barnave Veterinare në Departamentin e Toksitologjisë Monitorimit të Mbetjeve dhe Cilësisë”.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, sipas propozimit të bërë me shkresën nr. 321 prot., datë 10.06.2015, “Propozim për ristrukturim të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”, të Komisionit të Ristrukturimit, ka marrë vendimin përfundimtar të transferimit për çdo punonjës të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Më tej, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë këtij subjekti, ka ekzekutuar vendimin përfundimtar të transferimit, me nr. 2896/1 prot., datë 22.09.2015, të Departamentit të Administratës Publike, duke njoftuar punonjësit për transferimin e tyre. Transferimi i këtyre nëpunësve, për shkak të ristrukturimit të institucionit, është bërë sipas kërkesave ligjore të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për statusin e nëpunësit civil”, të ndryshuar dhe pikës 19, të vendimit nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” (tashmë i shfuqizuar), duke u finalizuar me aktet administrative individuale për secilin punonjës, nga njësia përgjegjëse (DAP).

Konkluzion: Në përfundim të analizës së kësaj pike të programit të mbikëqyrjes, Komisioneri vlerëson se, në lidhje me procedurat e kryera për sistemimin e nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, nga pikëpamja ligjore nuk ka parregullsi.

Punonjësit e sistemuar në pozicionet e riorganizuar i plotësojnë kushtet specifike të vendit të punës.

Të dhënat që pasqyrojnë realizimin e procedurës së transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, për shkak të ristrukturimit të institucionit, janë të pasqyruara në mënyrë analitike në **aneksin nr. 3**, që i bashkëlidhet raportit si pjesë përbërëse e tij.

➤ **Konstatim:**

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, me Urdhrin e Kryeministrit, nr. 127, datë 23.08.2016, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISUV”, është miratuar një strukturë e re për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe aktualisht ky institucion ndodhet në fazë ristrukturimi.

Me shkresën nr. 600, datë 30.08.2016, të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është dërguar pranë DAP, kërkesa për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit. Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me urdhrin nr. 152, datë 08.06.2016, “Për krijimin e komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”, ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit me këtë përbërje:

- Një përfaqësues i njësisë përgjegjëse (DAP), kryetar i komisionit, (***** me detyrë Specialiste në Sektorin e Sekretariatit Teknik për TND, në Drejtorinë e Politikave të Rekrutimit në Departamentin e Administratës Publike).
- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, *****, anëtar, si nëpunësi më i lartë civil i institucionit qendror nga i cili varet ISUV.
- Drejtori i ISUV, *****, anëtar, si nëpunësi më i lartë civil i institucionit.

Konstatohet se, kjo strukturë e re është në fazën e implementimit të saj dhe Komisioni i Ristrukturimit është në procesin e analizës që kërkohet nga ligji në këtë rast.

VIII. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm Disiplinor)

Instituti i disiplinës në shërbimin civil rregullohet në mënyrë të hollësishme në Kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, nga nenet 57 deri 61, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këtë kapitull përcaktohen në mënyrë specifike përgjegjësia për masat disiplinore, llojet e masave disiplinore; kompetencat dhe procedura për masat disiplinore; parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore dhe shuarja e masës disiplinore.

Në zbatim të këtyre dispozitave, në vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil” si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkëlqeve disiplinore”, janë përcaktuar procedurat e

hollësishme dhe të gjitha masat që duhet të ndërmerren nga personat kompetentë për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Ligji i posaçëm dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në rastin e konstatimit të shkeljeve disiplinore përcaktojnë procedura të hollësishme, të cilat duhet të ndiqen nga personat kompetentë të ngarkuar nga ligji për fillimin e ecurisë disiplinore. Shkeljet disiplinore shumë të rënda janë përcaktuar në pikën 2, të nenit 57, të ligjit dhe në këtë rast, masa disiplinore që zbatohet ndaj nëpunësit civil, është *“largim nga shërbimi civil”*, i parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 58, të ligjit në fjalë.

Në kuadër të drejtimeve të mbikëqyrjes, pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me praktikën e masave disiplinore, që janë aplikuar në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, konstatohet se për 1 punonjëse është dhënë masë disiplinore, e cila paraqitet si më poshtë:

- Punonjësjë *****, e cila në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ka qenë e emëruar në pozicionin e punës, *“Specialist, në Sektorin e analizave të PMB dhe Monitorimit të Mbetjeve dhe Cilësisë”*. Me aktin nr. 1198/26, datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, është deklaruar statusi i saj i punësimit si *“nëpunës civil”*. Me vendimin nr. 749, datë 21.11.2014, të Komisionit Disiplinor, është vendosur marrja e masës disiplinore *“Lirim nga shërbimi civil”*, për shkak të shkeljes së përsëritur të rregullave të etikës në shërbimin civil.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, akti për dhënien e masës disiplinore ndaj nëpunëses së mësipërme, ka dalë duke respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat e hollësishme të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”* dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë disiplinore dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*.

Në rastin konkret, Komisioni Disiplinor është ngritur me urdhrin nr. 199/b prot., datë 29.10.2014, të Drejtorit të ISUV-it. Gjatë shqyrtimit të këtij procedimi administrativ disiplinor, konstatohet se të gjithë vendimmarrjet e Komisionit Disiplinor janë bërë në mbështetje të përcaktimeve të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Kreut II, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*.

Konkretisht, gjatë procedimit administrativ disiplinor është garantuar e drejta e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit (njoftimi nr. 193/b prot., datë 23.10.2014). Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar çështjen në datën 29.10.2014, ku janë evidentuar të gjitha faktet dhe materialet e dosjes disiplinore, në ngarkim të nëpunëses civile *****, e cila i kishte depozituar me shkrim pretendimet e saj rreth shkeljes në fjalë, gjatë seancës dëgjimore. Komisioni, pasi ka vlerësuar rrethanat e ngjarjes që kanë qenë të nevojshme në përputhje me

Kodin e Procedurave Administrative, ka marrë vendimin nr. 749, datë 21.11.2014, për marrjen e masës disiplinore “Lirim nga shërbimi civil”, për shkak të shkeljes së përsëritur të rregullave të etikës në shërbimin civil.

Nëpunësja civile ***** e ka ankimuar aktin e lirimit nga shërbimi civil në Gjykatën Administrative, si organi kompetent për të shqyrtuar këtë çështje. Me vendimin nr. 649, datë 12.02.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë së paditëses *****. Aktualisht, kjo çështje është duke u gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, pas ushtrimit të së drejtës së ankimit nga paditësja *****.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, Komisioni Disiplinor ka vepruar drejt duke respektuar dispozitat dhe procedurën e parashikuar në Kreun X, “Disiplina në shërbimin civil” që përfshin nenet 57, deri 61, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil” dhe Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

IX. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe mënyra e realizimit të procesit nga zyrtarët kompetentë

Vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë është parashikuar në nenin 62, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Kjo dispozitë parashikon se vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që realizohet çdo 6 muaj. Ndërsa në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, periudha e vlerësimit është një vit dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil.

Më tej, në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ndryshuar me vendimin nr. 252, datë 30.03.2016, të Këshillit të Ministrave, janë përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave të vendosura, vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit; detyrat e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit; nivelet e shkallëzuara të vlerësimit si dhe të drejtat e nëpunësit në rastet kur ai nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili konsiston në zhvillimin e fazës së planifikimit, në të cilën duhet të identifikohen objektivat kryesore të punës dhe sjelljet profesionale që duhet të përmbushë nëpunësi; zhvillimin e fazës së bisedimeve të ndërmjetme për të vlerësuar progresin e nëpunësit që i nënshtrohet vlerësimit; si dhe në vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, ku zyrtari raportues, bën një vlerësim të përmbledhur në arritjen e objektivave kryesore të punës për nëpunësin që do të vlerësohet.

Gjatë verifikimit u konstatua se, formularët e vlerësimit të punës janë hartuar sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2, pjesë e vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ku janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A); të dhënat për kontekstin e punës ku

identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (*ndarja B*); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (*ndarja C*); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, shpeshësinë e orëve të punës jashtë orarit, kërkesën për këshillim, trajnim dhe ngritjen profesionale (*ndarja Ç*); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmbledhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit.

Në zbatim të programit të kontrollit, për të gjithë nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes punonin në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, u verifikuan vlerësimet vjetore të rezultateve në punë të vitit 2014-2015 dhe 2015-2016.

Duke pasur parasysh katër nivelet e vlerësimit “shumë mirë”, “mirë”, “kënaqshëm” dhe “jo kënaqshëm”, nga verifikimet e kryera, vlerësimi përfundimtar i tyre, paraqitet si më poshtë:

Tabela 1: *Niveli i vlerësimit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015*

Niveli i vlerësimit përfundimtar	Janar – Qershor 2015			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	29	20	4	-
Totali	53			

Tabela 2: *Niveli i vlerësimit për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2015*

Niveli i vlerësimit përfundimtar	Korrik – Dhjetor 2015			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	14	38	4	1
Totali	57			

Tabela 3: *Niveli i vlerësimit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2016*

Niveli i vlerësimit përfundimtar	Janar – Qershor 2016			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	21	33	1	1
Totali	56			

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, institucioni i kontrolluar i ka kryer procedurat e vlerësimit të rezultateve në punë sipas përcaktimeve të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për

vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, duke kryer vlerësimin sipas formatit të përcaktuar në Lidhjen nr. 1 të vendimit të sipërcituar.

Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së vlerësimit, apo në përfundim të periudhës së provës, rezultojnë të jetë miratuar nga nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit, të cilët në zbatim të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, kanë plotësuar në mënyrën e duhur të gjitha elementët formale të kërkuara nga formulari i vlerësimit.

Nga vlerësimet e dhëna për nëpunësit e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, konstatohet se ata janë vlerësuar me nivele të ndryshme, si niveli 1 *“Shumë mirë”*, niveli 2 *“Mirë”*, niveli 3 *“Kënaqshëm”* dhe niveli 4 *“Jo Kënaqshëm”*. Pavarësisht vështirësisë për të matur nga jashtë saktësinë dhe efikasitetin e vlerësimeve të kryera nga personat kompetentë, kjo procedurë tregon për një qëndrim të kujdesshëm nga ana formale, në kryerjen e detyrës si nga njësia e personelit ashtu dhe nga ana e eprorëve direkt.

Sjellim në vëmendje se, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil, synon të përmirësojë aftësitë profesionale të nëpunësve, si dhe të ndikojë në cilësinë e shërbimit të ofruar prej tyre. Për këtë arsye, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit, (*Zyrtari raportues/Zyrtari kundërfirmues/Zyrtari autorizues*), duhet t’u përfundojnë secilën periudhë të vlerësimit, brenda afateve të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, të ndryshuar. Në pikën 12, shkronja *“b”*, të këtij vendimi është parashikuar që për 6 mujorin e parë të vitit vlerësimi realizohet në periudhën 1-15 korrik dhe për 6 mujorin e dytë të vitit në periudhën 1-15 janar. Më tej në pikën 18 është përcaktuar se, *“Jo më vonë se 15 ditë nga data e përfundimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, njësia e burimeve njerëzore e institucionit detyrohet të përfshijë në Regjistrin Qendror të Personelit formularin e vlerësimit për çdo nëpunës civil”*.

Nuk konstatohen raste të mosmarrëveshjeve ndërmjet *Zyrtarit raportues dhe/ose Zyrtarëve kundërfirmues dhe autorizues*, lidhur me nivelet e vlerësimit, për shkak të pretendimeve të nëpunësit, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë.

X. Organizimi i Dosjes dhe Regjistrit Qendror të Personelit

a. Dosja e Personelit

Në zbatim të programit, u verifikuan dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*.

Në dosjen e personelit përfshihen dokumenta me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas Lidhjes nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Lidhur me dosjet e personelit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë konstatohet se, në çdo dosje janë të administruara dokumentat e identifikimit (fotokopje e pasaportës); dokumenta që tregojnë për gjendjen civile (çertifikata e gjendjes familjare); dokumenta që vërtetojnë edukimin arsimor (diploma e shkollës së lartë); dokumenta që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (akti i emërimit); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (çertifikata kualifikimi), si dhe aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit.

Konstatohet se, dosjet individuale të nëpunësve janë të sistemuara, ruhen në kushte të përshtatshme në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Përgjegjësjë e Sektorit të Burimeve Njerëzore, e cila është nëpunësja përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, në kuptim të Kreut I, pika 4, të vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*.

Nga verifikimi i dosjeve të personelit në disa raste u vërejtën mangësi të lidhura me mungesën e raportit mjeko ligjor dhe vërtetimit të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti). Në mënyrë të hollësishme këto akte janë materializuar në **aneksin nr. 2** *“Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, deri në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”*, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara konstatohet se, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në datën 26.02.2014, ka pasur **64** pozicione pune në shërbim civil, nga të cilat:

- 19 nëpunës civil janë të gjinisë mashkullore ose 30% e numrit të përgjithshëm;
- 45 nëpunës civil janë të gjinisë femërore ose 70% e numrit të përgjithshëm;
- Moshë mesatare për meshkujt është rreth 52 vjeç;
- Moshë mesatare për femrat është rreth 48 vjeç;
- Moshë mesatare në total është rreth 50 vjeç.

Përsa i përket arsimit të nëpunësve pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, konstatohet se në përgjithësi nëpunësit civilë të institucionit të mbikëqyrur, rezultojnë të kenë diplomë të studimeve të larta universitare, të marra nga Universitetet Publike të Republikës së Shqipërisë dhe vetëm në 1 rast në arsimin jo publik (privat).

- 63 nëpunës zotërojnë diplomë të universiteteve publike,
- 1 nëpunës zotëron diplomë të universitetit jo publik, (privat).

Konkluzion: Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson që të sjelli në vëmendjen e njësisë që përgjigjet për ruajtjen dhe plotësimin e dosjeve të personelit se ato edhe në të ardhmen duhet të organizohen dhe të plotësohen në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, duke bërë pjesë të tyre të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në **aneksin nr. 2**, *“Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar*

aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në administratën e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

b. Regjistri Qendror i Personelit

Regjistri Qendror i Personelit si sistemi që ruan dhe përpunon të dhënat elektronike për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, është krijuar dhe administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

Institucioni i mbikëqyrur ka akses në sistem dhe e ushtron këtë funksion nëpërmjet specialistit të personelit. Në sistem bëhet plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të parashikuara në Lidhjen nr.3 *“Përkufizimi i administruesve dhe përdoruesve të sistemit”*, që i bashkëlidhet vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit të personelit”*.

*
* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga Komisioneri gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas objektit të tij, janë materializuar në tabelat e mëposhtme respektive për institucionin e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij raporti:

- 1. Aneksi 1 - “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil, i ndryshuar, (data 26.02.2014)”***
- 2. Aneksi 2 - “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil (në datën 26.02.2014), si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”.***
- 3. Aneksi 3 - “Aktet që materializojnë pozicionet e shërbimit civil në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për vitin 2016”.***

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA